



Prof. Dr. Dhurata Bozo (Frashëri)

Znj. Dhurata Bozo lindi në Tiranë në 28 Dhjetor 1959.

Ajo ka kryer për dy vite (1978-1980) studime universitare në degën Mjekësi e Përgjithshme në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, ndërsa në vitet 1980-1986 studimet e plota universitare në degën Biologji në Universitetin e Romës “La Sapienza”, ku u diplomua në Korrik 1986 në drejtimin e Biologjisë Molekulare Mikrobike.

Në shtator 1986 ajo u emërua pedagoge në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, ku vijoi deri në vitin 2003. Veprimtaria didaktike dhe kërkimore e Znj. Bozo është lëvruar në fushat e Biologjisë, Biologjisë Molekulare e Bioteknologjisë, duke kontribuar në mësimdhënie edhe si pedagoge e jashtme në Fakultetin e Mjekësisë në këto disiplina. Gjatë kësaj periudhe ajo krijoi dhe ngriti pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës drejtimin e ri të Bioteknologjisë.

Në Maj 1996 Prof. Bozo fitoi gradën shkencore Doktor i Shkencave në Biologji: Drejtimi Biologji Molekulare Humane, pas fitimit dhe zhvillimit të një projekti kërkimor individual 2 vjeçar në Laboratorin e Gjenetikës të Universitetit të Triestes, Itali. 5 vite më vonë, në Gusht 2001 fitoi titullin “Profesor i Asociuar” dhe në Janar 2015 titullin “Profesor”.

Znj Bozo ka mbajtur funksionin e Drejtores së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin në dy periudha kohore: 2003-2010 dhe 2014-2019. Në këtë funksion ajo ka dhënë kontribut në hartimin e legjislacionit dhe akteve të funksionimit të Sistemit të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë, duke qenë në të njëjtën kohë antare e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë për rreth 4 vite dhe antare e disa bordeve të organizatave të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në nivel ndërkombëtar. Në këtë kontekst ajo ka kontribuar si antare e Grupit Kombëtar të Reformës në Arsimin e Lartë dhe hartimit të legjislacionit të Arsimit të Lartë në Shqipëri në vitet 2007 dhe 2015, dhe e akteve të tjera nënligjore të fushës së Arsimit të Lartë dhe Sigurimit të Cilësisë dhe eksperte kombëtare në këtë fushë.

Gjatë viteve 2010-2014 dhe nga 2019 e në vazhdim, Znj. Bozo ka zhvilluar veprimtarinë e saj universitare si personel akademik me drejtim kërkimor në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit, pranë Universitetit të Sporteve të Tiranës, duke mbajtur për rreth dy vite (2012-2014) dhe pozicionin e Drejtorit të këtij Instituti. Ajo është angazhuar në procesin mësimor dhe kërkimor në fushat e Biologjisë, Biokimisë dhe Gjenetikës së Aktivitetit Fizik në shërbim të Shëndetit dhe Sportit. Aktualisht Prof. Dhurata Bozo është Përgjegjëse e Departamentit të Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit, pranë IKSHS dhe vijon veprimtarinë kërkimore e didaktike në të njëjtat drejtime.

Znj. Bozo është autore e botimeve të shumta shkencore në periodikë kombëtare dhe ndërkombëtare, tekste mësimore, pjesëmarrëse me referime kryesore në një sërë aktivitetesh shkencore kombëtare e ndërkombëtare dhe kontribuuese në realizimin e një sërë projektesh kombëtare në fushën e Bioteknologjisë dhe eksperte ndërkombëtare në këtë fushë për disa vite.

Tiranë, Maj 2021